

Të dashur prindër,

Hyrja në shkollë e fëmijës është një ndër momentet më të veçanta në jetën e një prindi, dhe një hap i madh në jetën e çdo fëmije. Kjo periudhë përfaqëson një tranzicion të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës, pavarësisht nëse ai ka ndjekur kopshtin apo ka qëndruar në shtëpi. Kjo kohë mund të ketë ndikim pozitiv në qëndrimin që fëmija ka ndaj shkollës dhe mësimin në përgjithësi.

Studimet tregojnë se familjarizimi me kërkesat e shkollës i ndihmon si fëmijët edhe prindërit të përshtaten më lehtë me shkollën dhe zvogëlon ankthin për fillimin e shkollës për të dyja palët.

Të gjithë nxënësve ju urojmë "rrugëtim" të mbarë gjatë vijimit nëntëvjeçar në shkollimin fillorë!

Çfarë do të mësoj në klasën e parë?

- Të respektoj të gjithë shokët dhe shoqet në mënyrë të barabartë
- Të kujdesem për mjedisin jetësor, kafshët dhe bimët
- Të mësoj se vajzat dhe djemtë janë të barabartë
- Të njoh çfarë është gënjeshtër dhe çfarë është e vërtetë
- Të mësoj se të gjithë e duam në mënyrë të barabartë vendin tonë, pa marrë parasysh se çfarë gjuhe flasim në shtëpi



Çfarë do të mësoj në gjuhën time amtare?

- Të filloj të lexojë dhe të shkruajë
- Të tregoj dhe ritregoj histori që dëgjoj
- Të shpreh mendimet dhe ndjenjat e mia në gjuhën time amtare
- Të prezantohem dhe t'u drejtohem me mirësjellje të tjerëve
- Të vlerësoj si të drejtën ashtu edhe të gabuarën në veprimet e mia dhe të njerëzve të tjerë
- Të tregoj ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët
- Të dijë të parashtoj dhe t'iu përgjigjem pyetjeve



Çfarë do të mësoj në shkencat natyrore?

- Të kujdesem për shëndetin tim përmes higjienës personale, aktivitetit fizik dhe ushqyerjes së shëndetshme
- Të bëjë dallimin midis karakteristikave të kafshëve, njerëzve dhe bimëve
- Të dalloj dhe krahasoj tingujt
- Të njoh pjesët e trupit tim
- Të dalloj materialet themelore dhe vetitë e tyre



Çfarë do të mësoj në matematikë?

- Të numërojë deri në 100, të shkruajë numra dhe të mbledhë dhe zbrësë deri në 20
- Të masë dhe të tregojë kohën
- Të zgjidhë detyra interesante duke menduar, me logjikë
- Të dalloj dhe vizatoj forma dhe figura gjeometrike



Çfarë do të mësoj në shoqëri?

- Të mësoj dhe të respektoj rregullat në shkollë
- Të mësoj cilat janë përgjegjësitë e mia si nxënës dhe cilat janë përgjegjësitë e mësimitdhënësit
- Të njoh ndjenjat e mia dhe të mësoj t'i përshkruaj ato
- Të mësoj për karakteristikat e mira të shokëve, shoqeve dhe shoqërisë
- Të mësoj për shtëpinë dhe familjen, si dhe përgjegjësitë në të
- Të dijë se të gjitha përgjegjësitë në shtëpi i përkasin njësoj çdo anëtar të familjes
- Të eksploroj mjedisin e vendit ku unë jetoj
- Të lëviz dhe të luajë në mënyrë të sigurt
- Të mësoj se ndryshimet janë një përparësi

